



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka paraqitur përpara gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kërkesën penale me objekt: Pushimin e procedimit penal nr. 1360, të vitit 2022 për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*” ndaj të kallëzuarit Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.
2. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorisë, me vendimin Nr. 1038, date 07.06.2024 ka vendosur: Shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizua si gjykatë kompetente, duke qenë se kallëzimi drejtohej ndaj një subjekti të posaçëm. Aktet janë regjistruar pranë kësaj të fundit më datë 11.06.2024 dhe është shortuar më datë 12.06.2024.
3. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 112, 75/a; 128, 128/a, pika 1, shkronja “b”, 131/2, 332/b e vijues të Kodit të Procedurës Penale si dhe ligjit nr. 95 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionin e institucioneve për të luftuar Krimin e Organizuar”, me vendimin Nr. 52, datë 10.07.2024, vendosi:
 1. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të aktit “Kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 1360, të vitit 2022 të Prokurorit, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, që ka si objekt hetimin e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*” ndaj të kallëzuarit **Gent Sejko**, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.
 2. Kthimin e akteve të procedimit penal nr.1360/2022 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, prokurores Dorina Bejko, në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
 3. Veprimet hetimore të urdhëruara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi duhet të kryhen brenda 3 (tre) muajve.
 4. Caktimin e seancës gjyqësore paraprake datë 16.10.2024, ditë e mërkurë, ora 10:00.

5. Urdhërohet sekretaria e gjykatës t'i njoftojë vendimin Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
6. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda afatit ligjor.

Tiranë më datë 10.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar